

## REFERAT

### **PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIN MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE DHE DIPLOMACIA 5.06 (5.06.00.06) DHE TJETËR 5.06 (5.06.00.09) (NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT) NË FAKULTETIN JURIDIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/18), nenit 32, 33, 34, 35 dhe 36 të Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. 01-4309/2 e datës 01. XII. 2021, dhe Konkursit për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Marrëdhënie ndërkombëtare dhe Diplomacia 5.06 (5.06.00.06) dhe Tjetër 5.06 (5.06.00.09) (nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) të shpallur më 19.02.2026 në gazetata ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më 11.03.2026, solli Vendim me nr. 13-9/3 të datës 11.03.2026, me të cilin formohet Komision recensues në përbërje të:

- 1. Prof. Dr. Shefik SHEHU** (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës,
- 2. Prof. Dr. Ebrar IBRAIMI** (anëtar) - profesor i asocuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës,
- 3. Prof. Dr. Vlona POLLOZHANI SHEHU** (anëtar) – profesor i asocuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

Si anëtarë të Komisionit recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, sjellim këtë

## RAPORT

Në konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Marrëdhënie ndërkombëtare dhe Diplomacia 5.06 (5.06.00.06)

dhe Tjetër 5.06 (5.06.00.09) (nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në afatin e paraparë është paraqitur vetëm kandidati:

**Doc. Dr. Gjeraqina Leka**

**1. Të dhëna biografike dhe arsimimi:**

Gjeraqina Leka lindi në Tetovë, me 18 prill 1990. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, në shkollën “Bratstvo Migjeni”. Në 2004 ajo u regjistrua në shkollën e mesme, gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë. Ndjekjen e mësimin në këtë shkollë e ndërpreu në dhjetor 2004, pasi u shpërngul në Kajro të Egjiptit, ku vijoi mësimin në shkollën e mesme amerikane “The American International School in Egypt”. Pas dy viteve të shkollimit të mesëm, në vitin e tretë dhe të katërt, u bë pjesë e programit të Maturës Ndërkombëtare (International Baccalaureate). Në përfundim të vitit të katërt, ajo u diplomua nga kjo shkollë në vitin 2008, duke marrë diplomë të dyfishtë: amerikane dhe të Maturës Ndërkombëtare. Gjatë diplomimit, ajo u shpall nxënësja më e mirë e gjeneratës (salutatorian).

Në shtator të po të njëjtit vit, ajo i regjistroi studimet në ciklin e parë, në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, në fushën studimore Shkencat Politike. Ajo u diplomua në vitin 2011, me notë mesatare 10.00, me çfarë u shpall si studentja më e mirë e gjeneratës (valedictorian).

Në shtator të vitit 2011, ajo i regjistroi studimet e ciklit të dytë, në programin e Diplomacisë, pranë Universitetit të Evropës Juglindore. Ajo u diplomua në vitin 2014, pas mbrojtjes së punimit të magistraturës me temë: “Roli i qeverive të koalicionit në hartimin e politikave të jashtme: Maqedonia si një rast studimi.” Ajo fitoi gradën Magjistër i Diplomacisë, ndërsa këtë cikël të studimeve e përfundoi me notë mesatare 9.93.

Në vitin 2015 ajo i regjistroi studimet e ciklit të tretë, në programin Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Menaxhimi i Konfliktëve, pranë Fakultetit Filozofik (Katedra e UNESCO-s) në Universitetin Shën Kirili dhe Metodi. Ajo i përfundoi këto studime pas mbrojtjes së disertacionit, nën mentorimin e Prof. Dr. Michael Schulz (Universiteti i Goteborgut, Suedi) me temë: “Ndikimet e jashtme mbi politikën e jashtme dhe marrëdhëniet ndër-etnike: rasti i Maqedonisë së Veriut”, dhe me notë mesatare 9.62, në janar të vitit 2021.

Përvoja e saj e punës filloi me punësimin në Kabinetin e Zëvendëskryeministrit për Çështje Evropiane, në Sekretariatit për Çështje Evropjane, pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në vitin 2012. Në vitin 2013 ajo u transferua me vend pune në Komunën e Tetovës

ku punoi në kabinetin e kryetarit, Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare, deri në vitin 2018. Detyrat e saj binin në rrafshin e marrëdhënieve ndërkombëtare, të përqendruara në bashkëpunimin me institucione e partnerë ndërkombëtar, realizimin e projekteve me dimension ndërkombëtar si: Vendosja e Sistemit të Integritetit, mbështetur nga UNDP (2010-2015); Projekti POWER (Rrjeti Evropian i Grave Kryetare Komunash) financuar nga Komisioni Evropian (2014-2016); Projekti Municipal Service Delivery (Ofrimi i Shërbimeve Komunale), miratuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së (2016), etj. Gjatë punës së saj në Komunën e Tetovës, Gjeraqina Leka ka qenë e emëruar si Personi Përfaqësues i Komunës në Qendrën Informativë të BE-së (EU info point), duke u angazhuar në realizimin e shumë akviteve midis Delegacionit të BE-së dhe Komunës së Tetovës.

Në prill të vitit 2018, Gjeraqina Leka bëhet pjesë e Universitetit të Tetovës, fillimisht e angazhuar kryesisht në kuadër të Zyrës së Përkthimeve dhe Zyrës për Përpilimin dhe Menaxhimin e Projekteve. Në kuadër të punës së saj si pjesë e Zyrës së Përkthimeve, Gjeraqina Leka ka realizuar përkthimin e lajmeve, fjalimeve, raporteve, përfshirë dhe përkthimin dhe lekturën e disa revistave shkencore dhe raporteve siç janë: International Journal of Human Sciences "Filologjia", numri special për Nënë Terezë, International Journal of Educational Research "Education" 2019, International Journal of Applied Sciences 2019, International Journal of Sports and Health 2018, International Journal of Social and Human Sciences "Philosophica" 2018, etj.

Nga viti 2020, Gjeraqina Leka është përfshirë në recensimin e artikujve shkencorë të dorëzuar për botim në revistën *Justicia*.

Paralelisht me punën e saj administrative në Rektoratin e UT-së, në vitin 2018 ajo u angazhua edhe në mësimdhënie, si asistente e jashtme në lëndën: Të drejtat e Njeriut. Në vitin vijues, ajo u angazhua përmes kontratës në vepër në mësimdhënie në katedrën e Studimeve Politike të Fakultetit Juridik, duke ushtruar funksionin e asistentes në lëndët: Hyrje në Shkencat Politike, Integritet në BE, Analizë e Politikës së Jashtme, Politika e Jashtme e SHBA-së.

Në dhjetor të vitit 2019 ajo u emërua përgjegjëse e Zyrës për Përpilimin dhe Menaxhimin e Projekteve. Në kuadër të këtij angazhimi, u realizuan një sërë aplikimesh dhe zgjerime të rrjeteve të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare. Fokusi i punës së Gjeraqina Lekës në krye të kësaj zyre është pjesëmarrja e gjerë në projekte me interes të përgjithshëm si dhe në ndërkombëtarizimin e mëtejshëm të universitetit përmes bashkëpunimeve në kuadër të programeve ndërkombëtare siç janë Erasmus +, Horizon 2020, IPA, Fulbright, USAID, CEEPUS network, WBF, si dhe përmes bashkëpunimit bilateral me institucione vendore dhe ndërkombëtare.

Gjatë punës së saj në krye të kësaj zyre, janë realizuar edhe një numër projektesh, ndër të tjera projekti *Art Bloom* (në kuadër të Erasmus + KA2); projekti për *Valorizimin e Malit Sharr*,

mbështetur nga UNEP dhe Ministria e Ambientit Jetësor; pjesëmarrja në cilësinë e partnerit të asociuar në aktivitetet e projektit *Aleancë e AURORA-s* (Aurora Alliance) në kuadër të Erasmus + përkrah universiteteve të tjera prestigjioze siç janë Vrije Universiteit Amsterdam, University of Iceland Copenhagen, Business School University of East Anglia, Univerzita Palackého v Olomouci; anëtarësimi i Fakultetit Juridik në *Asociacionin Evropian të Fakulteteve të Drejtësisë* (European Law Faculties Association); realizimi i *Seminarit të XIV Ndërkombëtar i Albanologjisë*, si pjesë e projekteve të fituara nga Ministria e Kulturës në thirrjen e vitit 2020; ripërtrirja e aplikimeve në rrjetin e CEEPUS III; realizimi i trajnimeve profesionale të studenteve femra nga departamenti i IT-së dhe Fakultetit të Shkencave të Zbatuara nga Instituti për Liderhip dhe Politika Publike; realizimi i projektit *Cyber Hygiene e-learning course*; mbështetur nga CRDF Global, dy mini grant projekte: *CROSS* (për përpilim propozimesh/projektesh në Horizon Europe) dhe *OS Galileo* (open science), etj. Gjatë kësaj periudhe është bashkëpunuar ngushtë dhe me vullnetarin nga Korpusi i Paqes, me të cilin janë realizuar disa aktivitete, si aplikime për logjistikë në Ambasadën Gjermane, aplikim në programin *Alumni Engagement Innovation Fund 2020*, pjesëmarrja në Punëtoritë virtuale me temë *Dizajnimi dhe Menaxhimi i Projekteve: Mjetet PACA*, etj. Gjeraqina Leka e përmbyll aktivitetin e saj në krye të zyrës për Përpilim dhe Menaxhim të Projekteve në korrik të vitit 2022.

Në vitin 2022, ajo emërohet si Përgjegjëse për Projekte në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, gjatë së cilës detyrë ajo ka aplikuar, koordinuar, asistuar në implementim të projekteve dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me fakultetin, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit, Statutin e Fakultetit Juridik dhe ligjet tjera, me të cilat rregullohen të drejtat dhe obligimet nga kjo përgjegjësi.

Në po të njejtin vit, me vendim nga Dekanati i Fakultetit Juridik, Gjeraqina Leka emërohet si Koordinatorë e Klubit Debatues të Fakultetit Juridik, i cili kishte për qëllim trajnimin e të rinjëve për debate kreative, njohja e tyre me stafin, infrastrukturën dhe shërbimet e ofruara nga fakulteti dhe universiteti, dhe përfshirja e studentëve, stafit, dhe nxënësve në aktivitete të përbashkëta arsimore-edukative. Në kuadër të këtij roli, Gjeraqina Leka, në koordinim me Zyrën për Arsim, gjatë semestrit pranveror, së bashku me kolegët e saj ka realizuar një sërë vizitash nëpër shkolla të mesme, ku kanë bashkëbiseduar me nxënësit, kanë realizuar ligjërata për ta, dhe i kanë njoftuar për programe, risi, dhe shërbime që i ofron Fakulteti Juridik, duke krijuar kështu rrjete bashkëpunimi midis shkollave të mesme dhe fakultetit.

## **2. Veprimtaria mësimore-arsimore:**

Në vitin akademik 2018-2021 kandidatja Gjeraqina Leka u angazhua si *asistente e jashtme (part-time)* në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës.

Më 2021 zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore *docent* në lëmin shkencor Marrëdhënie ndërkombëtare dhe historia e diplomacisë (50815 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës (Vendimi me nr. 13-608/1 i datës 16.07.2021).

Gjatë ushtrimit të punës së saj si docente, nga viti 2021/2022 deri në vitin 2025/2026, ajo ka ligjëruar një sërë lëndësh brenda diciplinës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në tri programet studimore të Fakultetit Juridik: Studime Politike, Studime të Drejtësisë, dhe Kriminalistikë. Nga fillimet e saj, në ciklin e parë ajo ka ligjëruar lëndë si *Politika e Jashtme e SHBA-së, UE integrimet, Studime Evropiane, Politika dhe Siguria e Jashtme e BE-së, Terrorizmi Ndërkombëtarë, OSBE dhe Siguria Evropiane, Hyrje në të Drejtën e UE-së, Ekonomia Politike Ndërkombëtare II, Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme të BE-së, Krimi i organizuar dhe terrorizmi*, duke ofruar njohuri të avancuara mbi diplomacinë, sigurinë, qeverisjen, dhe dinamikat globale politike. Ajo poashtu ligjëron në ciklin e dytë të studimeve, përkatësisht lëndët *Kriminaliteti i organizuar*, duke u thelluar në tema si strukturat, metodat, dhe impakti i krimit të organizuar por edhe mekanizmat ligjor, politik, e institucional për luftimin e krimit të organizuar, si dhe lëndën *Institucionet e BE-së dhe procesi i vendimmarjes*, ku studentët përfitojnë njohuri të detajuara mbi mënyrën se si institucionet e BE-së janë të organizuara, si ndërveprojnë me njëra tjetrën, si hartohen politikat dhe si funksionon përgjithësisht qeverisja komplekse e BE-së.

Përveç ligjëratave dhe ushtrimeve, kandidatja Gjeraqina Leka, realizon dhe konsultime me studentët e Fakultetit Juridik, gjegjësisht të të trija programeve studimore: Studime Politike, Studime të Drejtësisë dhe Kriminalistikë.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidatja Doc. Dr. Gjeraqina Leka ka realizuar gjithsej **65,8 pikë** nga **veprimtaria mësimore-arsimore**.

### **3. Veprimtaria shkencore-hulumtuese:**

*a) Rezultatet shkencore të kandidatit që janë me rëndësi të veçantë për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore:*

Veprimtaria shkencore dhe hulumtuese e Doc. Dr. Gjeraqina Lekës shtrihet në një gamë fushash akademike të cilat kanë të bëjnë kryesisht me politikën e jashtme, të specializuar në strategjitë e mëdha ose politikën e jashtme të shteteve të vogla, në studime të sigurisë, marrëdhënie ndër-etnike, lëvizjet sociale dhe rezistenca nga shoqëria civile, si dhe përfaqësimi politik i grave në Republikën e Maqedonisë së veriut.

Nga viti 2023, ajo poashtu është angazhuar si bashkëpunëtore e jashtme në projektin hulumtues, të udhëhequr nga School of Global Studies, University of Gothenburg, ku ajo bashkëhulumton efektet e intervenimit perendimor liberal paqësor mbi proceset shtet dhe paqëndrues si dhe rezistencën dhe aktivizmin që buron nga shoqëria civile në Ballkanin perendimor.

Në vitin 2022 ajo ka qenë pjesë e ekipit hulumtues të një projekti kërkimor të përbashkët midis Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës dhe Fakultetit Juridik të Vrije Universiteit Amsterdam, ku në cilësinë e bashkë-autores kanë botuar raport përmbledhës të gjetjeve dhe analizës së hulumtimit me temë: *Measuring experiences on corruption levels at public institutions in NorthMacedonia - region of Polog (2022)*.

Nga angazhimi I saj kërkimor-shkencor kanë rezultuar një sërë publikimesh të cilat vijojnë më poshtë.

*b) Pasqyra e punimeve shkencore, konferencave, seminareve në vend dhe jashtë vendit:*

### **3.1. Punime shkencore të botuara në revista profesionale dhe ndërkombëtare:**

1. **Leka, Gj.** (2025). Towards a Holistic Approach to Security and the Rule of Law in the Western Balkans. *Conference Proceedings from the International Conference: Towards a Secure European Area in a Globalized World*
2. **Leka, Gj.,** (2025). Identity and Ambition: North Macedonia's status seeking through its foreign policy (2006-2017). *Academicus International Scientific Journal*. Vol. 16, Issue 32.
3. **Leka, Gj., & Ibraimi, E.** (2025). The pivotal role of EU engagement in North Macedonia: internal cohesion implications amid geopolitical challenges. *Journal of Law And Politics*. Vol 6. Issue 1
4. **Leka, Gj., Shehu, S., & Ibraimi, E.** (2025). Analyzing North Macedonia's size and power in the context of its foreign policy conduct. *Academicus International Scientific Journal*. Vol. 16, Issue 31
5. **Leka, Gj., & Selimi O. Nj.**(2023). Women's Political Participation in North Macedonia: What has been achieved so far? *THESIS – International Research Journal*
6. **Leka, Gj., et al.** (2022). "Measuring experiences on corruption levels at public institutions in North Macedonia - region of Polog", *Universiteti I Tetovës dhe Vrije Universiteit Amsterdam*.
7. Selimi O. Nj., & **Leka Gj.** (2022). The domestic impact of foreign policy: the case of North Macedonia. *Freedom - Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication*
8. **Leka, Gj.** (2021). Security oriented foreign policy: theoretical approach. *Justicia – International Journal of Legal Sciences*, Vol. 9, Issue 15-16.

9. **Leka, Gj.** (2021). Inter-ethnic representation in North Macedonia's Foreign Policy. *Freedom -Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication*, Vol. 2, Issue ¾.
10. Zejneli, J., Ibraimi, E., & **Leka, Gj.** (2025). *Between Pragmatism and Resistance: Exploring Internal Divergence on Compromise in North Macedonia's Path to NATO and the EU* prezentuar në 10th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 12-13.11.2025, Universiteti i Tetovës.
11. **Leka, Gj.,** (2025). *Finding Solutions Through Defense Cooperation and Regional Frameworks*, prezentuar në Western Balkan Forum, George C. Marshall European Center for Security Studies, 26-29.08.2025, Garmisch-Partenkirchen, Germany.
12. **Leka, Gj.,** (2025). *Towards a Holistic Approach to Security and the Rule of Law in the Western Balkans*, prezentuar në konferencën ndërkombëtare Towards a Secure European Area in a Globalised World: The Security - Rule of Law Nexus, 02-03.06.2025, Universiteti i Tetovës dhe Universiteti Shën Kliment Ohridski – Manastir.
13. **Leka, Gj.,** & Ibraimi, E. (2024) *The pivotal role of EU engagement in North Macedonia: internal cohesion implications amid geopolitical challenges*, prezentuar në International Conference on Law and Politics: Contemporary Global Issues in Law and Politics, 17-18.10.2024, International Balkan University, Shkup.
14. **Leka, Gj.,** & Selimi, O. Nj. (2023). *Women's Political Participation in North Macedonia: What has been achieved so far?* Prezentuar në AAB Academic Institutional Conference: Women, Women's rights and Gender Studies, 05-06.05.2023, Prishtinë.
15. **Leka, Gj.** (2022). *The domestic impact of foreign policy: the case of North Macedonia*, prezentuar në 7th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 16-18.2022, Universiteti i Tetovës.
16. **Leka, Gj.** (2022) *Tackling illiberal and eurosceptic narratives from below*, prezentuar në kuadër të projektit të përbashkët midis Fakultetit Juridik dhe Qendrës për Strategji Evropiane – Eurothink, 09.03.2022, Universiteti I Tetovës
17. **Leka, Gj.** (2021) *The international and national impact of the contest with Bulgaria on the Republic of North Macedonia*, prezentuar në 3rd International Conference on Law and Arts, Pejë.

### **3.2. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe programe studimore jashtë vendit:**

1. Certifikatë për pjesëmarrje në *10th International Scientific Conference of the Faculty of Law*, 12-13.11.2025
2. Certifikatë për përfundimin e Studimit të *U.S. Institutes for Scholars on U.S. Foreign Policy* at the University of Delaware, 13.06-23.07.2025

3. Certifikatë për pjesëmarrje në konferencë shkencore, në kuadër të Western Balkan Forum, nga George C. Marshall European Center for Security Studies, 26-29.08.2025
4. Certifikatë për bashkë-organizim dhe pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare *Towards a Secure European Area in a Globalised World: The Security - Rule of Law Nexus*, nga Universiteti i Tetovës dhe Universiteti Shën Kliment Ohridski – Manastir, 02-03.06.2025
5. Certifikatë për pjesëmarrje në *International Conference on Law and Politics: Contemporary Global Issues in Law and Politics*, International Balkan University, 17-18.10.2024
6. Certifikatë për pjesëmarrje në *AAB Academic Institutional Conference: Women, Women's rights and Gender Studies*, 05-06.05.2023
7. Certifikatë për pjesëmarrje në *7th International Scientific Conference of the Faculty of Law*, 16-18.2022
8. Certifikatë për pjesëmarrje në projektin e përbashkët, *Tackling illiberal and eurosceptic narratives from below* midis Universitetit të Tetovës dhe Qendrës për Strategji Evropiane – Eurothink, 09.03.2022
9. Certifikatë për pjesëmarrje në *3rd International Conference on Law and Arts*, Pejë.

### **3.3. Projekte/trajnime:**

1. Bashkë-hulumtuese në projektin e udhëhequr nga School of Global Studies, University of Gothenburg, Universiteti i Gothenburg-ut, 2023 – në vazhdim.
2. Pjesëmarrëse në 6th Erasmus+ International Staff Week 2022, Olomouc, Czech Republic, 13-17.06.2022.
3. Koordinatorë, aplikuesë, dhe zbatuesë e projektit: Integrity and Anti-Corruption, Vrije Universiteit Amsterdam, AURORA, 2022, projekt i përbashkët i Fakultetit Juridik (Universiteti i Tetovës) dhe Fakultetit Juridik (Vrije Universiteit Amsterdam) në kuadër të mini-granteve që financoi Aleanca AURORA, 2022.
4. Bashkë-organizuese dhe pjesëmarrëse e trajnimit Social Entrepreneurship & Diversity and Inclusion, AURORA CDS, Universiteti i Tetovës, 30-31.03.2022.
5. Pjesëmarrëse në trajnimin Make it Stick: the Science of Successful Learning, Jim Lofton, Universiteti i Tetovës, 13-14.06.2023.
6. Pjesëmarrëse në trajnimin online: Transforming Higher Education through Collaborative Online International Learning (COIL) and (Community) Service Learning, held in Blagoevgrad, Bulgaria, organizuar nga Aurora Alliance (Network of European Universities), 4 - 6.10.2021.

7. Pjesëmarrëse në trajnimin online: Aurora Competence Framework Training, mbajtur në Olomouc, Republika Çeke, organizuar nga Aurora Alliance (Network of European Universities), 8 - 9.12.2021.
8. Pjesëmarrëse në Erasmus + Programme Staff Training Mobility, në Istanbul University, 21-25.06.2021.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidatja Doc. Dr. Gjeraqina Leka ka realizuar gjithsej **86,3 pikë** nga **veprimtaria shkencore-hulumtuese**.

#### **4. Veprimtaria profesionale-zbatuese:**

##### **4.1. Kaptinë libri**

1. Shehu, S., & **Leka, Gj.** (2021). Hate Speech: A Normative Reflection. Në V. Ameti (Eds.), *Hate speech during the election campaign of the 2020 parliamentary elections in the Republic of North Macedonia: the effects on the behavior of citizens in intergroup relations* (faqe 305-321). Tetovë: Universiteti i Tetovës

##### **4.2. Koordinatorë për përgatitjen e elaboratit të programit studimor të ri**

1. Koordinatorë për përgatitjen e Elaboratit të programit studimor të ciklit të parë Studime Politike, viti 2025.

##### **4.3. Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit**

1. Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezentim i programit studimor Studime Politike për vitet akademike nga 2022 deri 2025.

##### **4.4. Pjesëmarrëse në studim jashtë vendit**

1. Qëndrim studimor në SHBA në kuadër të programit të U.S. Institutes for Scholars on U.S. Foreign Policy at the University of Delaware, 13.06-23.07.2025

##### **4.5. Pjesëmarrje në projekte të realizuara**

1. Koordinatorë, aplikuese, dhe zbatuese e projektit: Integrity and Anti-Corruption, Vrije Universiteit Amsterdam, AURORA, 2022, projekt i përbashkët i Fakultetit Juridik (UT) dhe Fakultetit Juridik/ Vrije Universiteit Amsterdam në kuadër të minigranteve që financoi Aleanca AURORA, 2022.

2. Bashkë-organizuese dhe pjesëmarrëse e trajnimit Social Entrepreneurship & Diversity and Inclusion, AURORA CDS, Universiteti i Tetovës, 30-31 mars 2022.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati Doc. Dr. Gjeraqina Leka ka realizuar gjithsej **9,5 pikë** nga **veprimtaria profesionale-zbatuese**.

## **5. Veprimtari me interes më të gjerë:**

### **5.1. Anëtare e bordit shkencor redaktues dhe recenzuese e revistës shkencore / profesionale ndërkombëtare**

1. Justicia – International Journal of Legal Sciences; Vol. 9 (2021)

### **5.2. Anëtare e komisioneve në fakultet/universitet**

1. Anëtare e Komisionit Qendror për regjistrim të studentëve në ciklin e parë të studimeve, viti akademik 2022-2025.

### **5.3. Qëndrim studimor në botën e jashtme**

1. SHBA, Delaware, Universiteti i Delaware, 13.06.-23.07.2025

2. Gothenburg, Suedi, Universiteti i Gothenburgut, School of Global Studies (16-20.09.2024)

3. Gothenburg, Suedi, Universiteti i Gothenburgut, School of Global Studies (31.05-03.06.2023)

4. Pjesëmarrëse në 6<sup>th</sup> Erasmus+ International Staff Week 2022, Olomouc, Czech Republic, (13-17.06.2022)

5. Aurora Biannaul Tarragona, Universitat Rovira i Virgili (17-20.11.2021)

6. Erasmus + Programme Staff Training Mobility, Istanbul University (21-25.06.2021)

### **5.4. Udhëheqëse e zyrës për projekte**

Aktvendim për emërimin e udhëheqësit të Zyrës për përpilim dhe menaxhim të projekteve (vendimi nr. 04-4504/1, i datës 02.12.2019), ushtruar deri më korrik 2022.

### **5.5. Përgjegjëse për projekte në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës**

Përgjegjëse për projekte në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës (Vendim me nr. 13-950/1, i datës 03.11.2022)

### **5.6. Koordinatorë e klubit debatues të Fakultetit Juridik**

Vendimi me nr. 13-1262/1 me datë 30.12.2022

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidatja Doc. Dr. Gjeraqina Leka ka realizuar gjithsej **9,5 pikë** nga **veprimtaria me interes më të gjerë**.

## 6. Përfundim dhe propozim:

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar dhe njohjes personale të kandidatit, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-zbatuese dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidatja **Doc. Dr. Gjeraqina Leka** posedon cilësi shkencore dhe profesionale sipas Ligjit për arsimin e lartë dhe Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, nr. **01-4309/2** e datës **01. XII. 2021**, dhe ka grumbulluar **171,1 pikë** nga referencat profesionale, me këtë e ka tejkaluar numrin minimal të pikëve që janë të nevojshme për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **profesor i asocuar**.

Bazuar në atë që u tha më lart, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës, **Doc. Dr. Gjeraqina Leka** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **profesor i asocuar** në lëmin Marrëdhënie ndërkombëtare dhe Diplomacia 5.06 (5.06.00.06) dhe Tjetër 5.06 (5.06.00.09) (nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.

Tetovë, 18.03.2026

### Komisioni recensues:

**1. Prof. Dr. Shefik SHEHU** (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

---

**2. Prof. Dr. Ebrar IBRAIMI** (anëtar) – profesor i asocuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

---

**3. Prof. Dr. Vlona POLLOZHANI SHEHU** (anëtar) - profesor i asocuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

---

## FORMULARI 1

### KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

Kandidati: **Gjeraqina Agim Leka**

Institucioni: **Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomacia 5.06 dhe Tjetër 5.06 (5.06.00.06 dhe 5.06.00.09 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

### KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN MËSIMOR-SHKENCOR – PROFESOR I ASOCUAR

Nr.	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Suksesi mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht ka arritur sukses mesatar së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara në ciklin e parë dhe të dytë Suksesi mesatar në ciklin e parë është: <b>10.00</b> Suksesi mesatar në ciklin e dytë është: <b>9.93</b> Suksesi mesatar <b>9,97</b> për studimet e integruara	<b>Po</b>
2	Titulli shkencor - doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet  Emri i sferës shkencore: <b>Shkencat shoqërore (5)</b> , fusha shkencore: <b>Shkenca politike (5.06)</b> , lëmia shkencore: <b>Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomacia 5.06 (5.06.00.06) dhe Tjetër 5.06 (5.06.00.09)</b>	<b>Po</b>
3	Të publikuara së paku 5 (pesë) punime shkencore të recensuara <sup>1</sup> në publikime shkencor referente në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	<b>Po</b>
3.1	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensioneve dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër të revistave, të cilën do ta përcaktojë Këshilli Kombëtar për Arsimin të Lartë  1. Emri i revistës shkencore: <b><i>Academicus International Scientific Journal</i></b> 2. Emri i bazës elektronike të revistave: <b>EBSCO, CEEOL</b> 3. Titulli i punimit: <b><i>Analyzing North Macedonia's size and power in the context of its foreign policy conduct</i></b>	<b>Po</b>

<sup>1</sup> Për kandidatin/ët që ka publikuar më tepër se 6 (gjashtë) punime shkencore në publikime shkencore referente, komisioni recensues do t'i theksojë, vlerësojë me pikë dhe vendos në Formularin 2.

	4. Data e publikimit: <b>2025</b>	
3.2	<p>Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensimit dhe të cilat kanë këshill redaktues në të cilin marrin pjesë anëtarë nga së paku tre shtete, me ç'rast numri i anëtarëve nga një vend nuk mund t'i tejkalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <b><i>Academicus International Scientific Journal</i></b></p> <p>2. Këshilli redaktues ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendeve): 12 anëtarë, 7 shtete</p> <p>3. Titulli i punimit: Identity and Ambition: North Macedonia's status seeking through its foreign policy (2006-2017).</p> <p>4. Data e publikimit: 2025</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <b><i>THESIS – International Research Journal</i></b></p> <p>2. Këshilli redaktues ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas vendeve): 18 anëtarë, 11 shtete</p> <p>3. Titulli i punimit: Women's Political Participation in North Macedonia: What has been achieved so far?</p> <p>4. Data e publikimit: 2023</p>	<b>Po</b>
4	Zgjedhja e mëparshme në titullin mësitor-shkencor – <b>Docent</b> , numri dhe data e buletinit: <b>13-608/1</b> të datës <b>16.07.2021</b>	<b>Po</b>
5	<p>Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë</p> <p>1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësisë dhe shkathtësitë për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë: <b>Universiteti i Tetovës</b></p> <p>2. Lloji i trajnimit/përvoja/arsimimi për fitimin e aftësive dhe shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë: <b>Mësimdhënie</b></p> <p>3. Periudha e fitimit të shkathtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë: <b>2018-2025</b></p>	<b>Po</b>

## FORMULARI 2

### PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITIJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË DHE MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Gjeraqina Agim Leka**

Institucioni: **Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomacia 5.06 dhe Tjetër 5.06 (5.06.00.06 dhe 5.06.00.09 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

#### I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	Pikët
<b>1</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave</b> (cikli i parë i studimeve)					<b>31,2</b>
<b>1.1</b>	Politika e Jashtme e SHBA-së	0.04	2	15	4	<b>4,8</b>
<b>1.2</b>	UE integrimet	0.04	2	15	2	<b>2,4</b>
<b>1.3</b>	Studime Evropiane	0.04	2	15	2	<b>2,4</b>
<b>1.4</b>	Politika dhe Siguria e Jashtme e BE-së	0.04	2	15	2	<b>2,4</b>
<b>1.5</b>	Terrorizmi Ndërkombëtarë	0.04	2	15	4	<b>4,8</b>
<b>1.6</b>	OSBE dhe Siguria Evropiane	0.04	2	15	3	<b>3,6</b>
<b>1.7</b>	Hyrje në të Drejtën e UE-së	0.04	2	15	3	<b>3,6</b>
<b>1.8</b>	Ekonomia Politike Ndërkombëtare II	0.04	2	15	1	<b>1,2</b>
<b>1.9</b>	Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme të BE-së	0.04	2	15	3	<b>3,6</b>
<b>1.10</b>	Krimi i organizuar dhe terrorizmi	0.04	2	15	2	<b>2,4</b>
<b>2</b>	<b>Mbajtja e ushtrimeve</b> (cikli i parë i studimeve)					<b>19,35</b>
<b>2.1</b>	Politika e Jashtme e SHBA-së	0.03	2	15	4	<b>3,6</b>
<b>2.2</b>	UE integrimet	0.03	2	15	2	<b>1,8</b>
<b>2.3</b>	Studime Evropiane	0.03	2	15	2	<b>1,8</b>
<b>2.4</b>	Politika dhe Siguria e Jashtme e BE-së	0.03	2	15	2	<b>1,8</b>
<b>2.5</b>	Terrorizmi Ndërkombëtarë	0.03	2	15	4	<b>3,6</b>
<b>2.6</b>	Hyrje në të Drejtën e UE-së	0.03	2	15	3	<b>2,7</b>
<b>2.7</b>	Ekonomia Politike Ndërkombëtare II	0.03	2	15	1	<b>0,9</b>
<b>2.8</b>	Krimi i organizuar dhe terrorizmi	0.03	2	15	2	<b>1,8</b>
<b>2.9</b>	Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme të BE-së	0.03	1	15	3	<b>1,35</b>
<b>3</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave</b> (cikli i dytë i studimeve)					<b>6</b>
<b>3.1</b>	Institucionet e BE-së dhe procesi i vendimmarjes	0.05	2	10	5	<b>5</b>
<b>3.2</b>	Kriminaliteti i organizuar	0.05	2	10	1	<b>1</b>
<b>5</b>	<b>Përgatitja e lëndës së re</b>					<b>3</b>
<b>5.2</b>	Institucionet e BE-së dhe procesi i vendimmarjes					<b>1</b>
<b>5.3</b>	OSBE dhe Siguria Evropiane					<b>1</b>
<b>5.4</b>	Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme të BE-së					<b>1</b>
<b>6</b>	<b>Konsultime me studentët</b>					<b>1</b>
<b>6.1</b>	Konsultimet me studentët		50x10x0.002			<b>1</b>
<b>7</b>	<b>Mentorim</b>					<b>1,8</b>

<b>7.1</b>	Mentor i temave të diplomës	4 x 0.2	<b>0,8</b>
<b>7.2</b>	Mentor i temave të magjistraturës	1 x 1	<b>1</b>
<b>8</b>	<b>Anëtar i komisioneve</b>		<b>3,5</b>
<b>8.1</b>	Anëtar komisioni për vlerësim dhe mbrojtjen të punimit të diplomës	20x0.1	<b>2</b>
<b>8.2</b>	Anëtar i komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të magjistraturës	5x0.3	<b>1.5</b>
<b>Gjithsej (1+2+3+4+5+6+7+8)</b>			<b>65,8</b>

## II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>1</b>	<b>Teza të mbrojtura</b>	<b>12</b>
1.1	Teza e doktoratës, <i>External influence over foreign policy and inter-ethnic relations: the case of North Macedonia</i> , mbrojtur në Universitetin Shën Kirili dhe Metodi, Shkup	8
1.2	Teza e magistraturës, <i>The role of coalition governments in foreign policy making: the case of Macedonia</i> , mbrojtur në Universitetin e Europës Juglindore, Shkup	4
<b>2</b>	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë shkencore/profesionale</b>	<b>36,3</b>
2.1	<b>Leka, Gj.</b> , (2025). Identity and Ambition: North Macedonia's status seeking through its foreign policy (2006-2017). <i>Academicus International Scientific Journal</i> . Vol. 16, Issue 32, 36-55	6
2.2	<b>Leka, Gj.</b> , & Ibraimi, E. (2025). The pivotal role of EU engagement in North Macedonia: internal cohesion implications amid geopolitical challenges. <i>Journal of Law And Politics</i> . Vol. 6, Issue 1, 43-60	5x0.9= 4.5
2.3	<b>Leka, Gj.</b> , Shehu, S., & Ibraimi, E. (2025). Analyzing North Macedonia's size and power in the context of its foreign policy conduct. <i>Academicus International Scientific Journal</i> . Vol. 16, Issue 31, 121-140	6x0.8= 4.8
2.4	<b>Leka, Gj.</b> (2025). Towards a Holistic Approach to Security and the Rule of Law in the Western Balkans. <i>Conference Proceedings from the International Conference: Towards a Secure European Area in a Globalized World</i> , publikuar nga Universiteti I Tetovës dhe Universiteti "St. Kliment Ohridski"- Manastir., 60-63	2
2.5	<b>Leka, Gj.</b> , & Selimi O. Nj.(2023). Women's Political Participation in North Macedonia: What has been achieved so far? <i>THESIS – International Research Journal</i> , Vol. 12, Issue 2, 1-19	5x0.9= 4.5
2.6	Selimi O. Nj. & <b>Leka Gj.</b> , (2022). The domestic impact of foreign policy: the case of North Macedonia. <i>Freedom - Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication</i> , Vol. 3, Issue 5/6, 48-54	5x0.9= 4.5
2.7	<b>Leka, Gj.</b> (2021). Security oriented foreign policy: theoretical approach. <i>Justicia – International Journal of Legal Sciences</i> , Vol. 9, Issue 15/16, 53-67	5
2.8	<b>Leka, Gj.</b> (2021). Inter-ethnic representation in North Macedonia's Foreign Policy. <i>Freedom -Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication</i> , Vol. 2, Issue 3/4, 47-59	5
<b>3</b>	<b>Pjesëmarrje në takim shkencor / profesional me prezantim oral</b>	<b>16</b>
3.1	Zejneli, J., Ibraimi, E. & <b>Leka, Gj.</b> (2025). <i>Between Pragmatism and Resistance: Exploring Internal Divergence on Compromise in North Macedonia's Path to NATO and the EU</i> prezentuar në 10th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 12-13.11.2025, Universiteti i Tetovës	2
3.2	<b>Leka, Gj.</b> (2025). <i>Finding Solutions Through Defense Cooperation and Regional Frameworks</i> , prezentuar në Western Balkan Forum, George C. Marshall European Center for Security Studies, 26-29.08.2025, Garmisch-Partenkirchen, Germany	2
3.3	<b>Leka, Gj.</b> (2025). Towards a Holistic Approach to Security and the Rule of Law in the Western Balkans, prezentuar në konferencën ndërkombëtare Towards a Secure European Area in a Globalised World: The Security - Rule of Law Nexus,	2

	02-03.06.2025 Universiteti I Tetovës dhe Universiteti Shën Kliment Ohridski – Manastir	
3.4	<b>Leka, Gj., &amp; Ibraimi, E. (2024) <i>The pivotal role of EU engagement in North Macedonia: internal cohesion implications amid geopolitical challenges</i>, prezentuar në International Conference on Law and Politics: Contemporary Global Issues in Law and Politics, 17-18.10.2024, International Balkan University, Shkup.</b>	2
3.5	<b>Leka, Gj., &amp; Selimi, O. Nj. (2023). <i>Women's Political Participation in North Macedonia: What has been achieved so far?</i> Prezentuar në AAB Academic Institutional Conference: Women, Women's rights and Gender Studies, 05-06.05.2023, Prishtinë.</b>	2
3.6	<b>Leka, Gj. (2022). <i>The domestic impact of foreign policy: the case of North Macedonia</i>, prezentuar në 7th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 16-18.2022, Universiteti i Tetovës</b>	2
3.7	<b>Leka, Gj.(2022) <i>Tackling illiberal and eurosceptic narratives from below</i>, prezentuar në kuadër të projektit të përbashkët midis Fakultetit Juridik dhe Qendrës për Strategji Evropiane – Eurothink, 09.03.2022, Universiteti I Tetovës</b>	2
3.8	<b>Leka, Gj. (2021) <i>The international and national impact of the contest with Bulgaria on the Republic of North Macedonia</i>, prezentuar në 3rd International Conference on Law and Arts, Pejë, 12-13.11.2021.</b>	2
<b>4</b>	<b>Certifikata për pjesëmarrje në konferenca shkencore</b>	<b>16</b>
4.1	Certifikatë për pjesëmarrje në 10th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 12-13.11.2025	2
4.2	Certifikatë për përfundimin e Studimit të U.S. Institutes for Scholars on U.S. Foreign Policy at the University of Delaware, 13.06-23.07.2025	2
4.3	Certifikatë për pjesëmarrje në konferencë shkencore, në kuadër të Western Balkan Forum, nga George C. Marshall European Center for Security Studies, 26-29.08.2025	2
4.4	Certifikatë për bashkë-organizim dhe pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare Towards a Secure European Area in a Globalised World: The Security - Rule of Law Nexus, nga Universiteti I Tetovës dhe Universiteti Shën Kliment Ohridski – Manastir, 02-03.06.2025	2
4.5	Certifikatë për pjesëmarrje në International Conference on Law and Politics: Contemporary Global Issues in Law and Politics, International Balkan University, 17-18.10.2024.	2
4.6	Certifikatë për pjesëmarrje në AAB Academic Institutional Conference: Women, Women's rights and Gender Studies, 05-06.05.2023.	2
4.7	Certifikatë për pjesëmarrje në 7th International Scientific Conference of the Faculty of Law, 16-18.2022	2
4.8	Certifikatë për pjesëmarrje në 3rd International Conference on Law and Arts, Pejë, 12-13.11.2021.	2
<b>5</b>	<b>Pjesëmarrës në projekt shkencor ndërkombëtar</b>	<b>5</b>
5.1	Pjesëmarrëse në projektin kërkimor-shkencor mbi aktivizmin e shoqërisë civile, rezistencën dhe efektet e intervenimit liberal perendimor paqësor në Ballkanin Perendimor, udhëhequr nga School of Global Studies (Universiteti i Gothenburgut), 2023- në vazhdim	5
<b>6</b>	<b>Ligjëratë e mbajtur me ftesë të universitetit</b>	<b>1</b>
6.1	Ligjëratë online me ftesë të Universitetit të Tiranës, Instituti i studimeve evropiane me temë: Politika e zgjerimit të Bashkimit Evropian, 30.01.2026	1
<b>Gjithsej (1+2+3+4+5+6)</b>		<b>86,3</b>

### III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ZBATUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>1</b>	<b>Kaptinë nga libri</b>	<b>2</b>
1.1	Shehu, S., & Leka, G. (2021). HATE SPEECH: A NORMATIVE REFLECTION. Në V. Ameti (Eds.), <i>Hate speech during the election campaign of the 2020 parliamentary elections in the Republic of North Macedonia: the effects on the behavior of citizens in intergroup relations</i> (faqe 305-321). Tetovë: Universiteti i Tetovës	2
<b>2</b>	<b>Koordinatorë për përgatitjen e elaboratit për programi studimor të ri</b>	<b>1</b>
2.1	Koordinatorë për përgatitjen e Elaboratit të programit studimor të ciklit të parë Studime Politike, viti 2025	1
<b>3</b>	<b>Përgjegjëse e aktiviteteve brenda fakultetit</b>	<b>2</b>
3.1	Përgjegjëse për projekte në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës	1
3.2	Koordinatorë e klubit debatues të Fakultetit Juridik	1
<b>4</b>	<b>Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit</b>	<b>2.5</b>
4.1	Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezantim i programit studimor Studime Politike për vitet akademike nga 2021 deri 2025	0.5x5= 2.5
<b>5</b>	<b>Projekt realizues</b>	<b>1.5</b>
5.1	Integrity and Anti-Corruption, Vrije Universiteit Amsterdam, AURORA, 2022	1
5.2	Organizues i trajnimit Social Entrepreneurship & Diversity and Inclusion, AURORA CDS, Universiteti i Tetovës, 30-31 mars 2022	0,5
<b>6</b>	<b>Ligjërata në institucion me interes publik, qendra kulturore informative</b>	<b>0.5</b>
6.1	Ligjërata mbi Fazat e integritimit të RMV në BE, në kuadër të Shkollës për liderë të rinjë 'Peace Forum Dialogue' organizuar nga Ministria për system politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive 13.08. 2023	0.5
<b>Gjithsej (1+2+3+4+5+6)</b>		<b>9,5</b>

### IV. VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>1</b>	<b>Anëtar i këshillit redaktues të revistës ndërkombëtare shkencore/profesionale</b>	<b>1</b>
1.1	Justicia – International Journal of Legal Sciences; Vol. 9 (2021)	1
<b>2</b>	<b>Anëtar i komisioneve në fakultet/universitet</b>	<b>1,5</b>
2.1	Anëtare e Komisionit të fakultetit për regjistrim të studentëve në ciklin e parë të studimeve, viti akademik 2021/2022	0,5
2.2	Anëtare e Komisionit të fakultetit për regjistrim të studentëve në ciklin e dytë të studimeve, viti akademik 2022/2023	0,5
2.3	Anëtare e Komisionit të fakultetit për regjistrim të studentëve në ciklin e dytë të studimeve, viti akademik 2023/2024	0,5
<b>3</b>	<b>Qëndrim studimor në botën e jashtme</b>	<b>3</b>
3.1	SHBA, Delaware, Universiteti i Delaware, 13.06.-23.07.2025	0.5
3.2	Gothenburg, Suedi, Universiteti i Gothenburgut, School of Global Studies (16-20.09.2024)	0.5
3.3	Gothenburg, Suedi, Universiteti i Gothenburgut, School of Global Studies (31.05-03.06.2023)	0.5
3.4	Pjesëmarrëse në 6th Erasmus+ International Staff Week 2022, Olomouc, Czech Republic, (13-17.06.2022)	0.5

3.5	Aurora Biannaul Tarragona, Universitat Rovira i Virgili (17-20.11.2021)	0.5
3.6	Erasmus + Programme Staff Training Mobility, Istanbul University (21-25.06.2021)	0.5
4	<b>Drejtues i njësisë së brendshme organizative</b>	3
4.1	Udhëheqëse e Zyrës për menaxhim me projekte pranë Rektoratit të Universitetit të Tetovës (2019-2022)	3
5	<b>Pjesëmarrje në komisione dhe trupa në organe shtetërore dhe të tjera</b>	1
5.1	Konsulente e angazhuar nga Sekretariati për Çështje Evropiane, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2023-2024)	1
<b>Gjithsej (1+2+3+4+5)</b>		<b>9,5</b>

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE		Pikë
I.	VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	65,8
II.	VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	86,3
III.	VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ZBATUESE	9,5
IV.	VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË	9,5
<b>Gjithsej</b>		<b>171,1</b>

Tetovë, 18.03.2026

**Komisioni recensues:**

**1. Prof. Dr. Shefik SHEHU** (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

\_\_\_\_\_

**2. Prof. Dr. Ebrar IBRAIMI** (anëtar) - profesor i asocuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

\_\_\_\_\_

**3. Prof. Dr. Vlona POLLOZHANI SHEHU** (anëtar) - profesor i asocuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

\_\_\_\_\_

## REFERAT

### **PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIT TEORIA POLITIKE 5.06 (5.06.00.02), MENAXHIMI I KRIZËS 5.09 (5.09.03.06) DHE TJERË 5.09 (5.09.02.13) NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMIVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT) NË FAKULTETIN JURIDIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/18), nenit 32, 33, 34, 35 dhe 36 të Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. **13-520/1** e datës **24.06.2021**, dhe Konkursit për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në fushën Teoria Politike 5.06 (5.06.00.02), Menaxhimi i Krizës 5.09 (5.09.03.06) dhe Tjerë 5.09 (5.09.02.13) nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmive shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, të shpallur më 19.02.2026 në gazetatat ditore „Koha“, „Sloboden Peçat“ dhe web faqen e universitetit, Këshilli Mësimoro-Shkencor i Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më **11. 03. 2026**, solli Vendim me nr. **13-39/3** me të cilin formohet Komision recensues në përbërje:

- 1. Prof. dr. Bashkim SELMANI** (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës,
- 2. Prof. dr. Shefik SHEHU** (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.
- 3. Prof. dr. Agon DEMJAHA** (anëtare) - profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës,

Si anëtarë të Komisionit recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, sjellim këtë:

## RAPORT

Në konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në fushën Teoria Politike 5.06 (5.06.00.02), Menaxhimi i Krizës 5.09 (5.09.03.06) dhe Tjerë 5.09 (5.09.02.13) nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në afatin e paraparë është paraqitur vetëm kandidati:

**Prof. Dr. Bekim MAKSUTI**

## 1. Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidati Prof dr. Bekim Maksuti është i lindur në Shipkovicë të Tetovës ku e kryen shkollimin fillor ndërsa at të mesëm në Gjimnazin e Tetovës 1994-1997. Në vitin 1997 regjistrohet në Akademinë Ushtarake “Gjeneral Mihajlo Apostolski” - Shkup të cilin e kryen në vitin 2001 dhe fiton titullin oficer i këmbësores me 240 kredi ECST.

Pas përfundimit të studimeve deridiplomike më vitin 2005, kandidati Bekim Maksuti do të regjistrohet në studime të magjistraturës të paqes dhe zhvillimit pranë Institutit për Siguri, Mbrojtje dhe Studime të Paqes të Fakultetit Filozofik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup. Me temën “OKB-ja pas Luftës së Ftohtë dhe sidat për misionet paqeruajtëse” do ta mbron tezën e magjistraturës më 18.06.2009 dhe fiton titullin “**Magjistër i paqes dhe zhvillimit**”. Pas përfundimit të studimeve deridiplomike kandidati Bekim Maksuti do ti vazhdon studimet e doktoratës në po të njëjtin institucion dhe me temën “Ndikimi i kontesteve bilaterale të vendeve të Ballkanit Perëndimorë mbi reformat dhe plotësimin e kritereve për anëtarësim në NATO dhe BE”, dhe me 11.12.2013 do ta mbron disertacionin e doktoratës dhe do të fiton titullin shkencor “**Doktor i paqes dhe zhvillimit**”.

